

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA FERIZAJ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **656-25-2586-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, LOT I - Pajisje stomatologjike, LOT II - Pajisje për laborator, LOT IV - Pajisje radiologjike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Letamed SH.P.K.
NUI	812046276
Adresa	Nebih Hodo Kuci
Vendi	SUHAREKE
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	+38349541344
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Arjanit Bytyqi
Adresa elektronike	letamedcompany@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	16.06.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

LOT I - Pajisje stomatologjike **LOT II - Pajisje për laborator** **LOT IV - Pajisje radiologjike**

AK ka publikuar Njoftimin për vendimin e Ak ku ka rekomanduar për kontratë një Oe i cili ka cmimin më të lartë se oferta jone, ndërsa ne na ka eliminuar me arsyetime jo konform LPP-se.

Ne jemi OE më i lirë në LOT1 dhe LOT3 (Cekur nga AK Lot IV)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Lidhur me shkeljet e bera nga AK dhe eliminimin e ofertes sone pa asnjë bazë ligjore, ne kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë: 11.06.2025, por AK pa e analizuar fare, na ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, duke u thirrë në UA i cili flet kur OE nuk dorëzojnë specifikime teknike, por ky rast nuk është për ne sepse ne kemi dorëzuar specifikimet teknike së bashku me katalogjet në ofertën tonë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

RRegullores per prokurim publik 001/2022

UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet
























Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me datë: 09.06.2025 ka publikuar njoftim vendimin e AK ku ka rekomanduar për kontratë një OE I cili ka ofertën më të lartë se oferta jonë.

Ne LOT1 dhe LOT3 ne jemi Oe i përgjegjshëm, sepse kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-se dhe jemi OE me çmimin më të lirë, sipas kriterit të dhenies për këtë procedurë.

Ne si OE në këtë procedure, sipas AK jemi eliminuar me arësytimet: NUK KENI PLOTËSUAR KRITERIN: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe Nuk keni dorëzuar as Specifikimin Teknik.

Për vetë faktin që ZPP ka dhënë një arësytim të përgjithshëm, pa specifikuar se CILIN kriter nuk e kemi plotësuar ne si OE ofertues në këtë rocedurë, na jep të kuptojmë që AK fare nuk e ka vlerësuar ofertën tone, sepse në ofertën e dorëzuar nga ana jonë janë së paku: 16 Dokumente te emërtuara sipas kërkesave të dosjes së tenderit (SHIKO FOTON):

	CE Lot 1	4/28/2025 10:53 AM	File folder	
	CE lot 3	4/28/2025 10:59 AM	File folder	
	Sigurimi	4/28/2025 10:51 AM	File folder	
	1.Dokumentet e Letamed Shpk	6/26/2023 10:08 AM	WinRAR archive	1,549 K
	2.Lista e kontratave dhe referencat	4/18/2025 11:27 AM	WinRAR archive	986 K
	3.Garancion Ferizaj	4/25/2025 10:23 AM	Microsoft Edge P...	153 K
	4.ANEXI 2	4/28/2025 10:47 AM	Microsoft Edge P...	193 K
	5.Garancioni per X-ray	4/28/2025 10:42 AM	Microsoft Edge P...	137 K
	6.WS-0.15 Pulse Vacuum Horizontal Steril...	4/25/2025 9:53 AM	Microsoft Edge P...	265 K
	7.AP026	4/28/2025 10:28 AM	Microsoft Edge P...	1,934 K
	8.2025 APPLIED DENTAL DENTAL HANDPIE...	4/28/2025 10:39 AM	Microsoft Edge P...	6,230 K
	9.air compressor	4/23/2025 1:24 PM	Microsoft Edge P...	190 K
	10.CE Lot 1	4/28/2025 10:54 AM	WinRAR archive	5,151 K
	11.Gun type x ray catalogue	4/23/2025 11:06 AM	Microsoft Edge P...	1,033 K
	12.SENSOR CATALOGUE SIZE 2	4/19/2025 2:43 PM	Microsoft Edge P...	1,611 K
	13.Sigurimi	4/28/2025 11:02 AM	WinRAR archive	1,163 K
	14.CE lot 3	4/28/2025 11:10 AM	WinRAR archive	283 K
	15.Llot 1	4/28/2025 9:35 AM	Microsoft Edge P...	324 K
	16.Llot 3	4/28/2025 9:36 AM	Microsoft Edge P...	157 K
	deklarate-liferim Ferizaj	4/28/2025 10:41 AM	Microsoft Word D...	54 K
	LOT 3 - Pajisje për radiologji (1)	4/28/2025 9:28 AM	Microsoft Excel W...	54 K
	LOT I - Paisje për stomatologji (1)	4/28/2025 9:26 AM	Microsoft Excel W...	34 K
	Template per Dosja e Tenderit (3)	4/28/2025 10:48 AM	Microsoft Word 9...	497 K

Pasi kemi pranuar Letren Standarde, ne kemi dorezuar kerkesen per RISHQYRTIM te AK dhe quditerisht, pa e aprovuar kerkesen per rishqyrtim, AK na ka refuzuar kerkesen, por ne aresyetimin e refuzimit, nuk e ka cekur se cilen kerkese te kapacitetit teknik dhe profesional nuk e kemi plotesuar.

Ne aresyen e refuzimit te kerkeses per rishqyrtim, AK tash ka cekur vetem mos dorezimin e specifikimeve teknike:

Arsyeja e eliminimit Tuaj ka qenë: “Ju keni dorëzuar katalogun, por nuk është dorëzuar specifikimi teknik.

Në DT figuron aneksi nr.1 –“Specifikimet teknike të detyrueshme” si dhe në Udhëzuesi NR. 002/2024, për Plotësim Ndryshimin e Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik neni 10 Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu (“specifikimit teknik” – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale të një produkti, ndërsa OE duhet të dorëzoj specifikimin e detajuar të mallrave të ofruara).- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm”.

KJO NUK QËNDRON sepse SPECIFIKIMET TEKNIKE jane dorezuar ne oferten tone ne dokumentin e quajtur: :

6,7,8 dhe 9 Katalogjet për LOT1 dhe 10,11 Katalogjet për LOT3.

Pra ne kemi ofruar 16 file dokumente ku janë përfshirë të gjitha dëshmitë sipas kërkesave të FDT-së. Pjese eketyre dokumenteve jane edhe SPECIFIKIMET TEKNIKE per te cilat AK po deklarone se nuk i kemi dorezuar.

Nga kjo që e cekem më sipër, AK del që ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së sepse ne dëshmitë që i cekem më sipër siq janë dokumentet e ofertës sonë me nr.r: 6,7,8,9,10,11 (Janë katalogjet së bashku me specifikimet teknike).

Ne jemi të befashuar me këto arësytetime nga ana e AK, sepse të gjitha dëshmitë që i ka kërkuar ua kemi ofruar me ofertën tonë, ndersa AK na ka eliminuar duke dhënë arësye në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, e qka është më shqetësese, AK ka DËMTUAR BUXHETIN e AK sepse ka rekomanduar një OE i cili ka ofertat më të larta në të dy LOT/PJESË 1 dhe 3.

Kërkojmë nga OSHP që të aprovojë ANKESEN, të detyrojë AK që të kthejë lëndën në RIVLERËSIM, të vlerësohet oferta jone konform kërkesave të FDT-së dhe të na shpall ne fitues si OE i përgjegjshëm me cmimin më të lirë në LOT 1 dhe LOT3, e mos të dëmtojë buxhetin e AK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne jemi demtuar nga AK me kete procedure sepse aresyetime i dhene nga ana e AK

eshte sikur fare mos te jene hapur dokumentet e dorezuara nga ana jone, pra jemi trajtuar jo te barabarte ne kete procedure. Per kete ne si OE eshte dashur te konsultohemi me ekspert te cilet po ashtu na kane krijuar kosto shtese ne kete procedure.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*